



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E SHTIMES
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

Drejtoria për Shërbime Publike
Uprava za Javne Službe/Directorate of Public Service

Data/Datum/Date:	28. 2. 2020
Nr./Br./No	08/10
Për/Za/To:	Qytetarët e Komunës së Shtimes
Përmes/Preko/Through:	z. Naim Ismajli, Kryetari i Komunës
Nga/Od/From:	Halil Halili, drejtor i DSHP-së
Lënda/Predmet/Subject:	Njoftim – Aktivitete për përfshirjen e qytetarëve në sistemin e grumbullimit të mbeturinave

Të nderuar qytetarë të Komunës së Shtimes,

Drejtoria e Shërbimeve Publike (DSHP) në mbështetje nga kryetari i Komunës, Naim Ismajli është duke zhvilluar aktivitete të vazhdueshme me fokus të veçantë zvogëlimin e ndotjeve dhe rritjen e hapësirave të pastra në komunën e Shtimes dhe në këtë aspekt kemi rezultate inkurajuese. Prej datës 22 dhjetor 2019 kemi filluar aksionin dhe deri më sot (28. 2. 2020), afër 600 qytetarë janë përfshirë në sistemin e grumbullimit të mbeturinave dhe për këtë ne ju jemi shumë mirënjohës.

Megjithatë gjendja ende nuk është e mirë. Nga raporti i fundit nga Kompania Rajonale e Mbeturinave "Pastërtia" përqindja e qytetarëve që janë të përfshirë në sistemin e grumbullimit të mbeturinave nga 47 %, sa ishte në fund të dhjetorit 2019, tani ka arritur në 61%. Kjo do të thotë se ende 39 % e qytetarëve i hedhin mbeturinat në rrugë, fusha, lumë, ara ose male.

Duke pasur parasysh të gjitha këto fakte, DSHP-ja do të shtoj aktivitetet për të rritur presionin publik. Në ditët në vijim, duke krahasuar listat e përfshirjes në sistem do të identifikohen të gjithë ata që nuk janë në sistemin e grumbullimit të mbeturinave siç janë: Zyrtarët e Komunës, Punëtorët Shëndetësorë, Staf i Arsimit, pra të gjithë ata që marrin pagë nga Buxheti i Republikës së Kosovës, do t'u bëhet publike emri i tyre.

Të gjithë atyre që marrin pagë nga Buxheti i Republikës së Kosovës dhe i hedhin mbeturinat në rrugë, fusha, lumë, ara ose male, do të ju shqiptohen gjopa konform Udhëzimit Administrativ të MMPH Nr. 06/2018 për ndëshkimet me gjopa mandatore. Prandaj, apelojmë te të gjithë ata që ende nuk janë inkuadruar në sistemin e grumbullimit të mbeturinave që ta bëjnë sa më parë.

Viti 2020, 100% përfshirje në sistem dhe 0 deponi ilegale!

Adresa: Rr. "Tahir Sinani", nr.50, 72000, Shtime, Republika e Kosovës.

Tel.: +381290389016 ex 222 email: info@shtime-komuna.org

<http://kk.rks-gov.net/shtime>